



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 85 datë 29-08-2025

***PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
2025-2030, BASHKIA KORÇË***

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligjit 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Ligjit nr. 47/2018 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligjit 18/ 2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", Ligjit 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", Ligjil 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH, Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Ligjin nr.9936/2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi, dhe sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

- 1- Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030, Bashkia Korçë.
- 2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NACI

Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 29-08-2025





PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2030

Përgatitur nga Bashkia Korçë
në kuadër të zbatimit të
Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030
si dhe
Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore

Korrik, 2025

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2030 u përgatit nga Bashkia Korçë me mbështetjen e UN Women Shqipëri në kuadër të zbatimit të projektit: Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale për buxhetim të përgjigjshëm gjinor dhe politika gjithëpërfshirëse.

Me miratimin dhe zbatimin e këtij Plani, Bashkia Korçë riafirmon angazhimin e saj për të garantuar të drejtat dhe barazinë reale për të gjitha/gjithë qytetarët dhe qytetarët e saj. Vetëm përmes bashkëpunimit dhe përkushtimit të përbashkët mund të ndërtojmë një komunitet më të drejtë, më të barabartë dhe më solidar për të gjitha/gjithë.

Sotiraq Filo
Kryetar
Bashkia Korçë

I. HYRJE

Plan i Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 - 2030 u përgatit nga Bashkia Korçë, si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore¹.

Bashkia Korçë e ka nënshkruar këtë dokument të rëndësishëm të përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane², në 21 dhjetor 2016³, duke ndërmarrë kështu një angazhim publik për të bërë realitet arritjen e barazisë gjinore në Korçë. Ky angazhim shkon në përputhje dhe me detyrimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (objektivi specifik IV.3, aktiviteti IV.3.1.d.), me të gjitha standartet kombëtare e ndërkombëtare, si dhe në respektim të plotësimit të kërkesave për integrimin në Bashkimin Evropian. Në vitin 2018, Bashkia Korçë miratoi Planin e parë Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018 – 2020 dhe identifikoi edhe vështirësitë dhe sfidat që shoqëruan zbatimin e tij. Më pas, Bashkia Korçë ndërmori një sërë hapash për përmirësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve me ndjeshmëri gjinore, emëroi një person me pozicion të dedikuar si Nëpunëse e Barazisë Gjinore, duke e ndarë këtë pozicion nga Koordinatorja Vendore kundër Dhunës në Familje, përmirësoi e shtriu më tej gamën e shërbimeve, duke targetuar gra, të reja e vajza nga grupet e cenueshme, fuqizoi kapacitetet e të rejave dhe të rinjve, pilotoi studimin e ngacmimeve seksuale dhe llojeve të tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike⁴, fuqizoi efektivitetin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, etj. Në nivel të Këshillit Bashkiak, funksionon edhe Komisioni i Mirëqenies Sociale, Strehimit, Rinisë dhe Barazisë Gjinore, i përbërë nga gjashtë anëtare/anëtarë (4 gra dhe 2 burra).⁵

Plan i Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2030, u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, Këshillin Vendor Rinor, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtare e anëtarë të Këshillit Bashkiak.

I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Shqipëri në kuadër të Projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri" (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lira/lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011).

¹ Shih: https://ecre-geer.org/wp-content/uploads/2024/03/Charter_2022_EN.pdf

² Shih: <https://ecre-geer.org/>

³ Shih: https://charter-equality.eu/atlas-of-signatories-of-the-charter/signatories.html?send=ok&c_id=1&nrb_id=0&c_id=0

⁴ Studim i realizuar me mbështetjen e UN Women dhe IDRA Research and Consulting, 2019. Shih: https://eca.unwomen.org/sites/default/files/Files/200/ffce%20Albania/Attachments/Publications/2019/05/ALBANIAN_w eb.pdf

⁵ Shih: <https://bashkiakorca.gov.al/keshilli-bashkiak-keshill-keshilltare/>

e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe shoqëror.

Asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve, pra të të gjitha/gjithë anëtarëve dhe anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore.

Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithëpërfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PVVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja “në të gjithë diversitetin e tyre”, që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të të gjithë individëve, e në mënyrë të veçantë, të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj., pra nga të gjithë grupet në shoqëri. Ky term gjithashtu përdoret gjerësisht në dokumentet e Bashkimit Evropian, sidomos ato që janë pjesë e acquis të BE-së për barazinë gjinore, ku specifikisht adresojmë Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2020 – 2025, si dhe Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III 2021 – 2025/2027¹⁹ (EU GAP III). Theksi te gratë, të rejat dhe vajzat, nga të gjitha grupet në shoqëri, është vënë edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, dokumenti kryesor i politikave në nivel kombëtar që përshkruan veprimet që duhet të ndërmerren për përparimin drejt barazisë gjinore.

Prandaj, kudo në këtë tekst, togfjalëshë “në të gjithë diversitetin e tyre” nënkupton që veprimet dhe masat e ndërmarra synojnë të përfshijnë gra, të reja, vajza në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë e të ndërthurur si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj.

II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Në nenin 18 të Kushtetutës qartësohet shprehimisht se: *“1. Të gjitha/gjithë janë të barabarta/barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”*.

¹⁹ EU GAP III u përgatit fillimisht për periudhën kohore 2021 – 2025, por në nëntor të vitit 2023, BE vendosi të shtrijë kohëzgjatjen e tij deri në vitin 2027. Shih: https://ec.europa.eu/equalty-action-plan-external-action-build-its-achievements-2023-11-21_en

- Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- Ligji Nr. 37/2017 "Kodi i drejtësisë penale për të mitur".
- Ligji Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".
- Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i procedurës penale", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin".
- Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit".
- Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë", i ndryshuar etj.

c) Politikat kombëtare

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2025 - 2030 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030**.¹⁴

d) Institucionet përgjegjëse

Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjëse/përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, të cilat/cilët përveçse brenda institucionit të tyre raportojnë, sipas kërkesës, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. *Megjithatë, ky Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, nuk është plani i një nëpunëseje/nëpunësi të vetëm, por është një dokument i Bashkisë, për zbatimin me efektivitet të të cilit mban përgjegjësi i gjithë stafi i bashkisë dhe njësisë administrative, në bashkëpunim dhe me të gjithë institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në këtë drejtim.*

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe *Aleanca e Grave Këshilltare dhe Komisioni i Mirëqenies Sociale, Strehimit, Rinisë dhe Barazisë Gjinore*¹⁵ në nivel të Këshillit Bashkiak.

Për të pasur efektivitet në zbatimin e PVVBGJ dhe monitorimin e vazhdueshëm të këtij zbatimi, Bashkia Korçë ka planifikuar si pjesë të veprimeve të këtij PVVBGJ edhe ngritjen e një *Komisioni për Barazi Gjinore / Grupi Monitorimi* në nivel bashkie, i përbërë nga përfaqësueset e përfaqësues të Drejtorive përgjegjëse për zbatimin e këtij PVVBGJ, duke

¹⁴ Miratuar me VKM nr.400, datë 30.06.2021. Shiko: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>

¹⁵ Shih: <https://bashkiakorca.gov.al/bashkili-bazisiale-keshilli-keshilltarat/>

III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2025 - 2030 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- **Ngritja e Grupit të Punës.** Grupi i Punës për hartimin e këtij PVVBGJ u ngrit me Urdhër të Kryetarit, nr. 44, datë 21.01.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030". Në përbërje të këtij grupi ishin 13 anëtare/anëtarë, nga të cilat/cilët 12 gra dhe 1 burrë.
- **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk revieë).** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues apo draft dokumentesh të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.
- **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PVVBGJ 2025-2030.** Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan nga identifikimi i prioriteteve bazuar në desk revieë, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë.
- **Konsultimet paraprake brenda bashkisë.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratoret/administratorët e NJA-ve. Ky hap u konsiderua i domosdoshëm, së pari për të mundur njohjen me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore për të gjitha/gjithë ata persona që nuk e kishin këtë informacion më herët, por edhe për të diskutuar mbi detaje që lidhen me formatin dhe përmbajtjen në tërësi të PVVBGJ. Janë zhvilluar gjithsej *katër takime të Grupit të Punës*, përkatësisht në datat 6 shkurt 2025, 26 mars 2025, 11 prill 2025 dhe 29 prill 2025.
- **Konsultim me një grup të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh.** Grupi i Punës mendoi që në takimin e tretë të tij (përkatësisht në datën 11 prill 2025) të flote edhe një rreth të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh, për të diskutuar parimisht mbi përmbajtjen e PVVBGJ. Ky takim rezultoi shumë i suksesshëm, me shumë diskutime e propozime konkrete nga të ftuarat/ftuarit. Po kështu, një takim konsultues i dedikuar u realizua edhe me të rejtat dhe të rinjtë, përfaqësuese e përfaqësues të Këshillit Vendor Rinor, në datën 29 prill 2025.
- **Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2025 - 2030.** Drafti matrica e përgatitur për konsultimet paraprake e partnerët, bashkëpunëtorët dhe rininë, përmbante masat dhe veprimet e parashikuara të përfshira në pesë fusha ndërhyrjeje, ku katër të parat bazoheshin në fushat prioritare të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 (pra fuqizimi ekonomik, pjesëmarrja në vendimmarrjen politike e publike, dhuna me bazë gjinore dhe integrimi gjinor në nivelin vendor), si dhe një fushë e pestë me masa të ndryshme të propozuara, të cilat pas konsultimeve paraprake, u saktësuan në cilat prej

Parimet²⁰ që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ₂ janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, siç paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumfishta.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, në vendimmarrje, është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

Fushat kryesore të ndërhyrjes

PVVBGJ 2025 - 2030 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbytje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.
- II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.
- III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.
- IV. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore.

²⁰ Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccrp.org/en/uploads/attachments/inline/charte_explique_al.pdf

II.1.a. Numri i të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, që kanë përfunduar trajnime për zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe për integrimin gjinor në vendimmarrje.

II.1.b. Përqindja e grave dhe të rejave drejtuese, në të gjithë diversitetin e tyre, në strukturat vendimmarrëse në Bashki, Këshillin Bashkiak, Njësitë Administrative, Këshillat e Fshatrave, etj.

Fusha e ndërhyrjes:

III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.

Rezultatet e pritshme:

III.a. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe efikas.

III.b. Një brez i ri i barazisë, që lufton stereotipet gjinore, praktikatat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë, i krijuar dhe fuqizuar.

III.c. Veprimet e bashkisë për ndërtimin e komuniteteve të sigurt, të paqta e gjithëpërfshirëse, të përmirësuara ndjeshëm.

Objektivat specifikë:

III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.

III.2. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.

III.3. Fuqizimi i grave, të rejave dhe të rinjve, për ndërtimin e komuniteteve të sigurt, përmes promovimit të Agjendës "Gratja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria".

Treguesit në nivel objektiv specifik:

III.1.a. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuar dhe të trajtuara nga MKR, krahasuar me numrin total të rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga Bashkia.

III.1.b. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

III.2.a. Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere të organizuara nga bashkia për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

III.3.a. Përqindja e grave, burrave, të rejave dhe të rinjve të përfshira/përfshirë në aktivitete që synojnë paqen, sigurinë dhe ndërtimin e komuniteteve të sigurt e gjithëpërfshirëse.

Fusha e ndërhyrjes:

IV. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Rezultatet e pritshme:

IV.a. Përgjegjshmëria dhe transparencja e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.

IV.b. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe integrimi gjinor i reflektuar në politikat dhe planet e bashkisë.

Objektivat specifikë:

ambienteve, etj. Po kështu, në ato raste kur masa apo veprimi është i parashikuar si detyrim parësor në një tjetër plan veprimi, në lidhje me kostot, është cituar referenca në planin përkatës, për të shmangur kështu mbivendosjet në përllogaritjet financiare.

- c. **Vlerën e kostos që mbulohet nga donatorët.** Kjo nënkupton që për zhvillimin e masës/aktivitetit ka një dakortësi paraprake me donatorët mbi kontributin e tyre. Në këtë rast, janë përllogaritur si të mbuluara, vetëm kostot për ato aktivitete që ka pasur një dakortësi / marrëveshje mes bashkisë dhe donatorit, në momentin e përgatitjes së këtij PVVBGJ. Paralelisht, bashkia do vijojë punën për identifikimin e donatorëve të ndryshëm dhe shtimin e mbështetjes nga ana e tyre, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij PVVBGJ.
- d. **Hendeku financiar.** Ky ka të bëjë me vlerën e kostos të pa mbuluar nga asnjë burim në momentin e miratimit të këtij plani. Kjo vlerë mund të mbulohet përmes negocimit me donatorët, bizneset, OJF të specializuara, etj., ose mund edhe të parashikohet brenda Planeve Buxhetore Afatmesme (PBA) e buxheteve vjetore, duke filluar nga PBA 2026-2028.

Kostot e paraqitura janë orientuese dhe miratimi i këtij Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2030, të kostuar, nuk nënkupton automatikisht edhe buxhetimin e tij. Për të buxhetuar dhe alokuar fondet përkatëse të përvitshme, pa të cilat zbatimi i këtij PVVBGJ nuk merr jetë, Bashkia duhet të përfshijë në parashikimet buxhetore vjetore dhe afatmesme edhe masat e parashikuara në të. Në këtë kuadër edhe mbështetja dhe lobimi nga vetë gratë këshilltare për sigurimin e burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve / masave, përmes përfshirjes së tyre në buxhete vjetore apo afatmesme të Bashkisë, është domosdoshmëri.

Me rishikimin e përvitshëm të Planit Vendor të Veprimit, *duhet bërë patjetër edhe rishikimi i kostove të propozuara*, bazuar edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në buxhetet vjetore apo PBA-të e Bashkisë, si dhe në marrëveshjet me donatorët apo partnerët e mundshëm. Kjo kërkon një vëmendje të shtuar sidomos në periudhën e përgatitjes së PBA-ve dhe buxheteve vjetore, për të përfshirë në to masat dhe veprimet e parashikuara në matricën e PVVBGJ, sipas ndarjeve në vite.

Nga përllogaritjet e bëra rezulton se kostot në tërësi për zbatimin e PVVBGJ 2025 - 2030 janë në vlerën **44,066,362 lekë**. Nga këto:

- **1,837,652 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes I “Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre”.
- **1,780,008 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes II “Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor”.
- **38,449,034 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes III “Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje”.
- **1,999,668 lekë** janë kosto për zbatimin e fushës së ndërhyrjes IV “Integrimi gjinor në politikat vendore”.

III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.	III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.	35,849,016 lekë	30,137,336 lekë	92,000 lekë	5,619,680 lekë
	III.2. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.	2,250,578 lekë	1,493,828 lekë	21,000 lekë	735,750 lekë
	III.3. Fuqizimi i grave, të rejave dhe të rinjve për ndërtimin e komuniteteve të sigurt, përmes promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria".	349,440 lekë	170,190 lekë	171,600 lekë	7,650 lekë
Gjithsej Objektivi strategjik III:		38,449,034 lekë	31,801,354 lekë	284,600 lekë	6,363,080 lekë
4. Integrimi gjinor në politikat vendore.	IV.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.	459,252 lekë	147,972 lekë	52,056 lekë	259,224 lekë
	IV.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjigjshëm	1,540,416 lekë	998,218 lekë	98,448 lekë	443,750 lekë

VII. MATRICA E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 – 2030

Lista e ndërtyrës (Objektivi strategjik)	1. PROMOVIMI I TË DREJTAVE PRONARIEK SOCIALI DHE TË PUNËSIMIT TË DËNJË, SI DHE FUQIZIMI I VAJZAVE TË REJAVE DHE GRAVE NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE									
Rezultatet e pritshme:	I.a. Veprimet e bashkisë për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm. I.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.									
Dokumentet kryesore që u referohemi:	- Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore - nenet 11, 17, 27. - Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË) – nenet 11, 12, 13. - Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPFA) – fusha kritike 6. - Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) – neni 12/6. - Plan i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE (EU GAP III) – shtylla III, fushat kryesore tematike 3.3, 3.6. - Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021 – 2030 – objektivat specifike 1.1, 1.2, 1.3.									
Objektivi specifik:	I.1. Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.									
Treguesit:					Baseline: (2025)	Target: (2030)	MONITORIMI			
I.1.a. Numri i grave dhe të rejave përfituese nga aktivitetet e fuqizimit të kapaciteteve (trajnime dhe programe të formimit profesional), ndarë sipas moshës, përkatësisë etnike-kulturore, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, llojit të aftësive të përfituara (llojit të trajnimit), etj.					Do përcaktohet	Rritur me 10% (2% çdo vit)	Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie / Grupi i Monitorimit të PVVBGJ; Komisioni i Mirëqenies Sociale, Strehimit, Rinisë dhe Barazisë Gjinore, si dhe anëtarët/anëtarët e Këshillit Bashkiak.			
I.1.b. Numri i sipërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të reja, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.).					Do përcaktohet	Rritur me 2.5% (0.5% çdo vit)				
